



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "THOMA PAPAPANO" GJIROKASTËR

Nr. 431 Prot.

Gjirokastër, më: 19/12/2022

Lënda : Njoftim për vend të lirë pune , (Me kohë të pjesëshme)

(Mundësi për lëvizje paralele)

Drejtuar: Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse

Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun

Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr. 15 datë 16/02/2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019 "Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe të Funkcionit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për Mënyrën e Organizimit dhe Veprimtarisë së Institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe Aspektet e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore , Përbërjes së Njësisë së Zhvillimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Zhvillimit të Vazhduar Profesional të Personelit", si dhe Udhëzimin nr. 28, datë 14.10.2019, "Për Numrin e Nxënësve për Klasë dhe Normat e Punës Mësimore në Institucionet e Arsimit Profesional " .Udhëzimin nr 26 ,date 22/09/2022 " Për disa ndryshime dhe shtesa ne Udhëzimin nr. 28, datë 14.10.2019, "Për Numrin e Nxënësve për Klasë dhe Normat e Punës Mësimore në Institucionet e Arsimit Profesional " Shkolla e Mesme Profesionale : "Thoma Papapano", Gjirokastër, ju njofton për krijimin e një vend të lirë pune ,me kohë të pjesëshme , në pozicionin e mësuesit te teorise profesionale , lenda " Bazat e Sipërmarrjes" .

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit të AFP-së duhet të përmbushë këto kritere:

1. Kritere të përgjithshme:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar:

- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

2..Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim profesional:

- a) të kete diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlefshme, në të njëjten fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-se
- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentet e aplikimit.

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

Letërmotivimin për pozicionin;

Jetëshkrimin (Cv-ne sipas shtojcës 11 të udhëzimit 14 dt. 27.05.2021.

Kartën e identitetit;

Diplomën;

Librezën e punës;

Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet , trajnimet apo të tjera të përmendura në CV:

Çertifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

Vërtetimin e gjëndjes shëndetësore;

Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore: Vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij ,nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi

të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara; Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda dates 04.01.2023.



Renata Puleri